



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

---

V E N D I M

Nr.2491, datë 17.07.2014

Për

**Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz" dhe Njoftimin për tender publik.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- |                |            |         |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro     | Xhixho     | Kryetar |
| 2. Z. Alban    | Karapici   | Anëtar  |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar  |
| 4. Z. Benon    | Paloka     | Anëtar  |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe      | Anëtar  |

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 17.07. 2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz" dhe Njoftimin për tender publik.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative".
2. Neni 69 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

3. VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 1.3 "Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave" i ndryshuar me VKM Nr.501 date 09.06.2010 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.1252 datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave";
4. Dokumentit - shkresa Nr.2381 Prot., date 16.06.2014, (Pro.t i AKEP: 893/4, datë 24.06.2014) e Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, "Miratimi i kufizimit të dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, procedurën e konkurimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre"
5. Urdhërin Nr. 1239, datë 26.06.2014 "Për zhvillimin e tenderit publik për dhënien e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave".

### K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Dokumentat e hartuar nga njësia e hartimit të dokumentave së bashku me relacionin përkatës
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

Dokumentacioni për **Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz"** dhe **Njoftimin për tender publik** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës. **Njoftimi për tender publik** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

### P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- Dokumentin e Tenderit;
- Njoftimin për tender publik;
- Shkresën Nr.2381 Prot., date 16.06.2014, (Pro.t i AKEP: 893/4, datë 24.06.2014) e Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, "Miratimi i kufizimit të dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave

të brezit 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, procedurën e konkurimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre” dhe

- Urdhërin Nr. 1239, datë 26.06.2014 “Për zhvillimin e tenderit publik për dhënien e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave”

#### V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin e Tenderit publik me “Procedurë të hapur” me objekt: *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz”*, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të miratojë Njoftimin për Tender, sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Njoftimi për tender të botohet në një gazetë ndërkombëtare dhe dy herë në gazetë kombëtare.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

#### ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI \_\_\_\_\_
2. Alketa MUKAVELATI \_\_\_\_\_
3. Benon PALOKA \_\_\_\_\_
4. Zamira NURÇE \_\_\_\_\_